



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 225, Datë 06.09.2022

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALBPETROL” SH.A., NË  
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME  
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 141, DATË 06.09.2017**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d”, dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.09.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1510/3 prot., datë 02.09.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 141, datë 06.09.2017”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 13.07.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- ERE bëri njoftimin në median e shkruar për këtë vendimmarrje, i cili u botua në datat 15.07.2022 dhe 16.07.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve të mundshme nga të tretët (data e fundit 28.07.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 971/2 prot., datë 27.07.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.

- Në vijim të e-mailit të shoqërisë, protokolluar në ERE me nr. 971/2 prot., datë 08.08.2022, me anë të të cilit ka depozituar dokumentacion plotësues sikurse ka deklaruar se do të depozitojë në vijim dhe dokumentacion shtesë për këtë aplikim, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 204, datë 10.08.2022, vendosi të shtyjë deri më 06.09.2022 afatin e vendimmarrjes për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 970/2 prot., datë 22.08.2022, duke evidentuar dhe dokumentacionin e mbetur ende pa plotësuar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 970/3 prot., datë 31.08.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues për këtë aplikim dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik dhe administrativ; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”, nenit 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”, nenit 9, pika 3, gërmat “a”, “c” dhe “d” si dhe nenit 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, “g”, “h” dhe “i”.
- Në lidhje me dokumentacionin financiar shoqëria duhet të depozitojë në ERE bilancin financiar të vitit 2021 sikurse depozituar në organet tatimore deri më 31 mars 2022 si dhe informacion/dokumentacion mbi sistemin IT që përdor për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën nr. 382, seria F17, shoqërisë “ALBPETROL” sha, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 141, datë 06.09.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 07.09.2022.

2. Brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e këtij vendimi, shoqëria “ALBPETROL” sh.a. duhet të depozitojë në ERE:
  - a) informacion/dokumentacion mbi sistemin IT që përdor për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**